A photograph of the AMF building, a modern multi-story structure with a white facade and large windows. A sign on the building lists contact information for the AMF.

fq. 2 Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së takohet me drejtues të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës për projektet e vitit 2015

VËSHTRIM MBI TREGJET

- » Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për muajin janar 2015 fq. 3
- » Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2014 fq. 4

ZHVILLIME TË TJERA

- » Seminar me temë “Administrimi i rrezikut në sigurime” fq. 6
- » Takime të Nënkomiteteve të IAIS-it fq. 7

LAJMET NGA RAJONI

- » Bosnje-Hercegovinë fq. 8
- » Çeki fq. 8
- » Estoni fq. 9
- » Kosovë fq. 9
- » Kroaci fq. 10

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së takohet me drejtues të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës për projektet e vitit 2015

Drejtorja e Përgjithshme Ekzekutive e AMF-së, Znj. Enkeleda Shehi, zhvilloi më datë 20 janar 2015 një takim me Drejtorët e Përgjithshëm të shoqërive të sigurimit të Jo-Jetës. Gjatë takimit Znj. Shehi bëri një pasqyrë të realizimeve të vitit 2014, problematikave të hasura dhe sfidave të zhvillimit në tregun e sigurimeve.

Znj. Shehi kërkoi angazhim maksimal nga shoqëritë e sigurimit, për përmbushjen e disa objektivave të rëndësishëm, që do të jenë në fokusin e AMF-së, si në vijim:

- » Zbatimi në vazhdimësi i masave për stabilizimin e tregut të sigurimit të detyrueshëm motorik: fondi i kompensimit dhe rezerva monetare;
- » Hartimi i projektligjit për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit dhe dërgimi i tij në Qeveri;
- » Zbatimi i ligjit të ri për veprimtarinë e sigurimeve dhe risigurimeve, si dhe plotësimit të kuadrit rregullator që AMF po përgatit në zbatim të këtij ligji;
- » Përmirësimi i shërbimit ndaj klientëve. Respektimi i afateve në trajtimin e dëmshpërblimit, kontrata cilësore dhe transparente;
- » Përmirësimi i cilësisë së agjenteve në sigurime - hartimi i një kodi etike për ndërmjetësit, standarde profesionale pune dhe shërbimi;
- » Zgjerimi i tregut me produkte të reja të sigurimit.

Në përfundim të takimit, Znj. Shehi theksoi rëndësinë dhe vëmendjen që AMF do t'i kushtojë gjatë vitit 2015, zbatimit të mbikëqyrjes me fokus rrezikun dhe kërkoi angazhim serioz nga shoqëritë për ndërtimin e sistemit të efektshëm të administrimit të rrezikut.

AMF, në zbatim të metodologjisë së re, po harton një rregullore me parimet e ndërtimit të sistemit të administrimit të rrezikut, e cila do t'i përcillet shumë shpejt industrisë për mendim.

Në përfundim, përfaqësues nga industria ngritën një sërë çështjesh që kërkojnë mbështetjen e AMF-së dhe vëmendjen e të gjithë aktorëve dhe institucioneve përgjegjëse. Disa nga këto çështje janë: monitorimi i zbatimit të pajisjes me sigurim të detyrueshëm të mjeteve të transportit publik, problematika në lidhje me unifikimin e limiteve të përgjegjësisë për produktet e sigurimit të detyrueshëm motorik për mjetet shqiptare që qarkullojnë në territorin e Kosovës, lehtësimi i procedurave për pajisjen me Karton Jeshil në kufirin me Malin e Zi, kalendari i pagesave të detyrimit të Fondit të Kompensimit në dy vitet e ardhme, etj.

VËSHTRIM MBI TREGJET

Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri për muajin janar 2015

Tregu i sigurimeve u rrit me 18.77% gjatë muajit janar 2015. Vlera e primeve të shkruara bruto gjatë muajit janar arriti rreth 1.18 miliardë lekë. Kjo u shoqërua me rritje të numrit të policave të sigurimit me 2.06% duke arritur në 74,401 polica.

Një tjetër tregues i ecurisë së tregut, dëmet e paguara bruto, në total, regjistruan një rritje me 7.00% në krahasim me muajin janar 2014. Pjesa më e madhe e dëmeve të paguara bruto i përket sigurimit motorik me rreth 0.17 miliardë lekë, apo 76.52% të totalit të dëmeve të paguara bruto.

Sigurimi i Jo-Jetës

Sigurimi i Jo-Jetës u rrit me 26.90% gjatë muajit janar 2015, krahasuar kjo me muajin janar 2014.

Sigurimi i detyrueshëm motorik

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik vlerësohet të kenë arritur vlerën rreth 0.66 miliardë lekë gjatë muajit janar 2015, duke shënuar një rritje prej 39.80% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar.

Sigurimi i detyrueshëm motorik gjatë muajit janar 2015 përbën 56.02% të tregut të sigurimeve.

Klasa të tjera në sigurimet e Jo-Jetës

Ndër klasat e tjera kryesore të sigurimit të Jo-Jetës veçohen:


- » zjarri, forcat e natyrës dhe dëmtime të tjera në pronë të cilat zunë 17.95% të tregut të Jo-Jetës;
- » sigurimi i aksidenteve, sigurimi i shëndetit dhe sigurimi i përgjegjësive të përgjithshme të cilat së bashku zunë 11.66% të tregut të Jo-Jetës.

Sigurimi i Jetës

Primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës u ulën me 27.99% krahasuar me muajin janar të vitit 2014. Pjesa më e madhe e primeve të shkruara bruto i përket sigurimit "Jetë debitor" i cili përbën 56.18% të sigurimit të Jetës.

Ndarja e tregut të sigurimeve, janar 2015

Grafiku më poshtë paraqet ndarjen e volumit total të primeve të shkruara bruto sipas grupeve kryesore.




Zhvillimet e Tregut me Pakicë të Letrave me Vlerë të Qeverisë për vitin 2014

Volumi i tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2014 u dominua në masën 77.74% nga transaksionet në instrumente afatshkurtër (*bono thesari*) dhe pjesa tjetër prej 22.26% ishin instrumente afatgjatë (*obligacione*). Përsa i takon numrit të transaksioneve, 98.35% e të gjitha transaksioneve të tregut sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë, i takojnë transaksioneve të kryera me bono thesari.

Të dhënat statistikore të tregut me pakicë të letrave me vlerë të Qeverisë gjatë vitit 2014 flasin për një dominim të transaksioneve “Blerje në tregun primar” dhe “Shlyerje e vlerës nominale në maturim” përkatësisht me 61.87% dhe 19.95% kundrejt volumit të përgjithshëm.

Pjesëmarrja në tregun sekondar të letrave me vlerë të Qeverisë dominohet nga investitorët individualë, të cilët kryejnë rreth 97.67% të të gjitha transaksioneve në këtë treg.

Letra me Vlerë të Qeverisë, Viti 2014



- A. Blerje në tregun primar
- B. Shitje nga portofoli i ndërmjësit financiar
- C. Blerje para afatit të maturimit
- D. Vendosje e bonos si kolateral
- E. Shlyerje e vlerës nominale në maturim

Dy grupet e transaksioneve B dhe C

Transaksioni i llojit **B “Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar”** gjatë vitit 2014, ka pasur një rritje prej 1,973 milionë lekë ose 37.82% krahasuar me vitin 2013, ndërsa numri i transaksioneve është rritur në masën 7.82%.

Transaksioni i llojit **C “Blerje para afatit të maturimit”** gjatë vitit 2014 ka pasur një rritje prej 454 milionë lekë ose 15.77% krahasuar me vitin 2013, ndërsa numri i transaksioneve është rritur në masën 5.67%.

Krahasuar me vitin 2013, vihet re një rritje në vlerë absolute e totalit të transaksioneve të llojit B dhe C të marra së bashku me rreth 2,427 milionë lekë.

Tregu me Pakicë i Letrave me Vlerë të Qeverisë

Lloji i Transaksionit		Vlera nominale		Ndryshimi
		<i>(në mln lekë)</i>		<i>(në %)</i>
Viti		2013	2014	'14/'13-1
B	Shitje nga portofoli i ndërmjetësit financiar	5,216.84	7,190.06	37.82
	<i>Individë</i>	<i>4,911.94</i>	<i>5,879.26</i>	<i>19.69</i>
	<i>Persona juridikë</i>	<i>304.90</i>	<i>1,310.80</i>	<i>329.91</i>
C	Blerje para afatit të maturimit	2,876.35	3,329.88	15.77
	<i>Individë</i>	<i>2,441.85</i>	<i>2,958.32</i>	<i>21.15</i>
	<i>Persona juridikë</i>	<i>434.50</i>	<i>371.56</i>	<i>(14.49)</i>

ZHVILLIME TË TJERA

Seminar me temë “Administrimi i rrezikut në sigurime”



Lektorja Holly Bakke gjatë zhvillimit të seminarit me temë “Administrimi i rrezikut në sigurime”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare (AMF) me mbështetjen e Korpusit Vullnetar të Shërbimeve Financiare (*Financial Services Volunteer Corps, FSVC*) zhvilloi në datat 12-16 janar 2015 seminarin me temë “Administrimi i rrezikut në sigurime”. Seminari u zhvillua në kuadër të zbatimit të metodologjisë së re të mbikëqyrjes, asaj me fokus rrezikun, e cila kërkon ngritje dhe forcim të kapaciteteve të administrimit të rrezikut.

Në seminar morën pjesë stafe teknike nga të gjitha shoqëritë e sigurimit që veprojnë në tregun shqiptar dhe që në fokusin e punës së tyre të përditshme kanë mbikëqyrjen dhe administrimin e rrezikut, si dhe stafi i mbikëqyrjes i AMF-së.

Disa nga temat kryesore që u trajtuan në seminar nga dy lektorë të Shteteve të Bashkuara të Amerikës, znj. Holly Bakke dhe z. Andrew Giffin, me përvojë të gjatë në fushën e sigurimeve ishin:

- » Procesi i administrimit të rrezikut (marrja në sigurime, tarifimi, administrimi i dëmeve, provigjoni, investimet, etj);
- » Identifikimi i rrezikut në shoqëri (mënyra e administrimit, kultura e organizatës, raportimi, vlerësimi i rrezikut dhe aftësisë paguese, etj);
- » Metodologjitë e administrimit të rrezikut dhe prioritizimi;
- » Analiza SWOT për tregun e sigurimeve.

Në përfundim të seminarit çdo shoqëri pjesëmarrëse hartoi një plan veprimi të veçantë rreziku në varësi të specifikave të tyre duke e bërë në këtë mënyrë programin të vlefshëm si për tregun dhe rregullatorin në sfidën e përbashkët për ndërtimin e praktikave sa më të shëndosha të administrimit të rrezikut dhe lehtësimin e tranzicionit për zbatimin e mbikëqyrjes me fokus rreziku.

Takime të Nënkomiteteve të IAIS-it

Organizata Ndërkombëtare e Mbikëqyrësve të Sigurimeve, (*International Association of Insurance Supervisors, IAIS*) në bashkëpunim me Bankën për Rregullime Ndërkombëtare (*Bank for International Settlements, BIS*) zhvilluan nga datat 16-18 shkurt 2015 në Bazel, Zvicër, takimet e Komiteteve dhe Nënkomiteteve të IAIS-it. Znj. Mimoza Kaçi, Nëndrejtoare Ekzekutive e AMF-së mori pjesë në këto takime.

IAIS drejtohet nga një Komitet Ekzekutiv, anëtarët e të cilit përfaqësojnë rajone të ndryshme gjeografike. Ai mbështetet nga Komiteti Teknik, Komiteti i Zbatimit, Komisioni për Buxhetin, Komiteti i Stabilitetit Financiar dhe Komiteti i Riskut dhe Auditimit.

Në Grupin e Punës për Zhvillimet e Mbikëqyrjes u diskutuan zhvillimet më të reja në drejtim të forcimit të bazës rregullative dhe mundësisë së trajnimit të stafëve të autoriteteve rregullatore me praktikat më të mira të mbikëqyrjes. Drejtuesit e seancave prezantuan programin “*First One*” si një format trajnimi i cili u ofrohet pa pagesë vendeve anëtare të IAIS-it. Ata inkurajuan autoritetet mbikëqyrëse që të shfrytëzojnë bibliotekën online të publikimeve dhe programin tashmë të specializuar “*FSI Connect*”. Në mbledhjet e zhvilluara u vu theksi në rëndësinë që merr bashkëpunimi rajonal dhe pjesëmarrja në seminare të përbashkëta trajnimi.

Në takime u diskutua edhe mbi programet e vetëvlerësimit (*Self-Assessment*) dhe u prezantuan raste studimore se si është zbatimi i Parimeve Themelore të Mbikëqyrjes (*ICP*) nga rregullatorë të vendeve të ndryshme në tregun e sigurimeve.

Mbledhjet e këtyre komiteteve janë të përvitshme dhe organizohen me synim ritheksimin e principeve, standardeve, si edhe për të dhënë mbështetje për çështje të lidhura me mbikëqyrjen në sigurime.

LAJMET NGA RAJONI

BOSNJE - HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Sipas të dhënave statistikore të dy autoriteteve që operojnë në tregun e sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës gjatë 2014, vlera e primeve të shkruara bruto shënoi 287.4 milionë euro, afërsisht 6.6 % më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, vlera e përgjithshme e dëmeve të paguara bruto është rritur me 24.2% duke arritur në rreth 127.6 milionë euro.

Në tërësi, primet e shkruara bruto në sigurimin e Jetës përbëjnë rreth 20.4% të totalit, afërsisht 58.5 milionë euro. Pjesa e mbetur, i takon sigurimit të Jo-Jetës. Nga klasat e përgjithshme të sigurimeve, 10.1% e primeve i përket sigurimit të pronës, 9.1% sigurimit Kasko dhe 47.8% sigurimeve MTPL.

ÇEKI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave të publikuara nga Banka Kombëtare e Çekisë, tregu i sigurimeve i mbikëqyrur nga ky autoritet, gjatë 2014, nuk shënoi ndryshime të mëdha. Primet e shkruara bruto shënuan vlerën rreth 4.38 miliardë euro me rreth 2.6% më shumë krahasuar me vitin të kaluar. Sigurimet e Jetës dhe Jo-Jetës patën zhvillime pozitive në rritje të primeve të shkruara bruto.

Në sigurimin e Jetës, primet e shkruara bruto u rritën me 4.24%, ndërsa në sigurimin e Jo-Jetës primet e shkruara bruto u rritën me 1.28%. Sipas të dhënave të Shoqatës së Sigurimit të Çekisë, shifrat tregojnë se pjesa më e madhe e rritjes së primeve erdhi prej policave të sigurimit kufitar. Duke përjashtuar këtë segment, primet e shkruara bruto në sigurimet e Jetës u rritën vetëm me 0.3%.

Sigurimi i pronës shënoi rritje me 9.8% të volumin e primeve dhe sigurimet MTPL me 8.74% të volumit të primeve të shkruara bruto. Edhe pse në totalin e tregut të sigurimit të Jo-Jetës niveli i dëmeve u ul me rreth 2.8% krahasuar me vitin e kaluar, për sigurimet MTPL u regjistrua një rritje 3.22% në volumin e dëmeve të paguara.

ESTONI

www.xprimm.com

Sipas shifrave të publikuara nga Bordi Kombëtar i Statistikave të Estonisë, siguruesit aktive në vend, në fund të shtatorit të 2014, shënuan një total të primeve të shkruara bruto rreth 253.5 milionë euro, ose 7.9% më shumë krahasuar me 2013. Në të njëjtën kohë, vlera e dëmeve të paguara mbeti pothuajse e pandryshuar me një vit më parë, duke arritur në 135.7 milionë euro.

Vlera e primeve të shkruara bruto, në sigurimet e Jetës u rrit me 11.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar, duke arritur vlerën rreth 58.6 milionë euro ose 23.1% të tregut të përgjithshëm të sigurimeve.

Në tregun e sigurimeve të Jo-Jetës, peshën më të madhe në primet e shkruara bruto e raportuan sigurimi Kasko në vlerën 68.1 milionë euro, ose 26.9% të totalit të primeve të shkruara bruto, sigurimi i pasurisë në vlerën 50.7 milionë euro, ose 20% dhe sigurimet MTPL në vlerën 50.1 milionë euro, ose 19.8% të totalit të primeve të shkruara bruto.

KOSOVË

www.xprimm.com

Sipas statistikave të publikuara nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, gjatë vitit 2014, tregu i sigurimeve në Kosovë mblodhi 80.08 milionë euro, ose 3.48% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit të kaluar. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara ranë me 18.90%, duke arritur në 31.18 milionë euro.

Dinamika pozitive e tregut lokal të sigurimeve është mbështetur fuqimisht nga rritjet e policave kufitare me 11.38% dhe sigurimet e tjera vullnetare me 13.75%. Klasa më e madhe e sigurimeve motorike, MTPL, pati një rënie prej 3.63% të volumit të primeve të shkruara bruto. Në portofolin e primeve të shkruara bruto rreth 52.86% e përbëjnë policat e sigurimit të detyrueshëm motorik, pasuar nga 18.22% policat e sigurimit kufitar dhe pjesa e mbetur janë klasat e tjera vullnetare të Jo-Jetës.

Në fund të vitit 2014, numri total i policave të shitura nga kompanitë e sigurimeve arriti në 998,000 krahasuar me 917,500 polica të shitura në vitin 2013. Rreth një e treta e këtyre policave i përkasin sigurimit MTPL.

Sipas statistikave të publikuara nga Byroja Kroate e Sigurimeve, gjatë vitit 2014, tregu i sigurimeve në Kroaci shënoi vlerën 1.11 miliardë euro, me një rënie 5.68% krahasuar me vitin e kaluar. Në sigurimin e Jo-Jetës primet e shkruara bruto shënuan vlerën 0.76 miliardë euro me një ulje prej 9.4%, ndërsa në sigurimin e Jetës primet e shkruara bruto shënuan vlerën 0.34 miliardë euro me një rritje prej 3.9% krahasuar me vitin 2013.

Në sigurimin e Jo-Jetës, rënia u ndikua më shumë nga sigurimi i pronës me rreth -8.76% dhe sigurimi MTPL me rreth -18.25%.

Sigurimet e Jetës gjatë 2014 shënuan një rritje me rreth 4.09% më shumë krahasuar me vitin e kaluar, ndërsa sigurimi mbi investimet u rrit me rreth 5.22%.